Sipas kriteve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (Shtojca 12)

Nëse oferta dorëzohet nga një Bashkim Operatorësh ekonomik, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht, dhe aneks kontrate ku perqindja e ndarjes eshte e percaktuar;
- b. Prokura e posaçme.

Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Kopje të çertifikuara të balanceve të vitit të fundit** (2019), të paraqitur në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet. Operatori ekonomik duhet te paraqese Raport Auditimi te Pavarur **vetëm në rastin** kur eshte në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar".
2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore per tre vitet e fundit nga data e zhvillimit te tenderit lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se cilës duhet të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës së fondit limit të realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitetet.

(Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga njësi vendore në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

4. Për Kapacitetin teknik:

1. Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me LPP dhe RRPP, si më poshtë:

Për të vërtetuar përvojën e Kontraktorit në projekte të ngjashme, duhet të ketë eksperiencë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, ose
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 1. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse;
 2. Situacionin përfundimtar;
 3. Aktin e kolaudimit;
 4. Certifikatën e marrjes në dorëzim.
 5. Fatura tatimore që i korespondon situacionit përfundimtar.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 2. Situacionin përfundimtar;
 3. Akt kolaudimi objekti;
 4. Çertifikatën e marrjes në dorëzim të objektit;
 5. Fatura tatimore.

Pika 3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.Liçencat profesionale që duhet të plotësojnë pjesëmarrësit, në varësi të llojit të punimeve për këtë objekt, do të jetë:

1. License per zbatim punimesh pikat NP.1 -Klasifikimi "A"

N.P. 1: Punime gërmimi në tokë.

2. License per zbatim punimesh pikat NP.7 -Klasifikimi "B"

N.P. 7: Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.

3. License per zbatim punimesh pikat N.P. 11 -Klasifikimi "A"

N.P. 11 : Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

4. License per zbatim punimesh pikat NP.12 -Klasifikimi "A"

N.P. 12 Punime të inxhinjerisë mjedisore

5. License per zbatim punimesh pikat N.S – 6 -Klasifikimi "A"

N.S.6: Sinjalistika rrugore jodriçuese

6. License per zbatim punimesh pikat NS.18 -Klasifikimi "B"

N.S.- 18: Punime topogjeodezike

7. License per zbatim punimesh pikat N.S – 9 -Klasifikimi "A"

N.S.9: Punime strukturore speciale

Të gjitha liçencat duhet të jenë të vlefshme për gjithë kohëzgjatjen e ndërtimit të objektit dhe sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

3. Operatori Ekonomik duhet te paraqesi deshmi per fuqine punetore per ekzekutimin e objektit te prokurimit brenda afatit te kerkuar. Fuqia punetore per realizimin e objektit te prokurimit duhet te jete jo me pak se 55 specialist dhe punetore te kualifikuar per keto lloj punimesh.

Per te permbushur kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese listë pagesat e konfirmuara nga Drejtoria Tatimore per 3 muajt e fundit, ku te jene te regjistruar mesatarisht 55 Punonjes. Si dhe te paraqesi Vertetim nga administrata tatimore per numrin e punonjesve per 3 muajt e fundit.

4. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë ne Licensen e kompanise për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, per muajin e fundit, të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme, diplomë.

Inxhinier ndertimi- 1 (nje)

Inxhinier mekanik – 1 (nje)

Inxhinier elektrik – 1 (nje)

Inxhinier gjeodet (ose Gjeomatik) – 1 (nje)

Inxhinier gjeolog -1 (nje)

Inxhinier hidroteknik -1 (nje)

Inxhinier mjedis – 1(nje)

Per Inxhinierin e Mjedisit te figuroje ne licensen e kompanise dhe te jete i pajisur me:

1.Certifikate per Hartimin e Raporteve te vlersimit te ndikimit ne mjedis.

4. Shoqëria pjesëmarrëse duhet të ketë ne stafin e kompanise për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme, diplomë:

1. Inxhinier Strukturist- 1 (nje)

2. Inxhinier Materiale- 1 (nje) I Certifikuar /trajnim per markaturen e materialeve

Te figurojne ne liste pagesat per 3 muajt e fundit.

5. Shoqeria duhet te kete ne stafin e saj punonjesit si me poshte:

1. 1 (një) “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, me standartin; OHSAS1 001–2007”. në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" Të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme, diplomë. Te figuroje ne listpagesat per 3 muajt e fundit.

2. 1 (një) Specialist ose inxhinier te jete i çertifikuar per testimin e performances së produkteve të ndërtimit. Të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme, diplome. Te figuroje ne listpagesat per 3 muajt e fundit.

3. 1 (një) "Përgjegjës për dëmet në mjedis" gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" Të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme .Te figuroje ne listpagesat per 3 muajt e fundit.

4. 1 (një) Ekspert Zjarrfikës i certifikuar. Të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme. Te figuroje ne listpagesat e shoqerise per 3 muajt e fundit.

5. 2 (dy) "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" i certifikuar. Të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme. Te figuroje ne listpagesat e shoqerise per 3 muajt e fundit.

6. 1 (një) Specialist per montim tubo HDPE i certifikuar. Të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme. Te figuroje ne listpagesat e shoqerise per per 3 muajt e fundit.

7. Teknik Ndertimi 2 (dy)

Të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme. Te figuroje ne listpagesat e shoqerise per 3 muajt e fundit.

8. Teknik Topograf – 1 (nje)

Të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme. Te figuroje ne listpagesat e shoqerise per 3 muajt e fundit.

9. Teknik Hidraulik – 1 (nje)

Të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme. Te figuroje ne listpagesat e shoqerise per 3 muajt e fundit.

10. Operatori ekonomik ofertues duhet te ket te punesuar minimalisht 6 (gjashte) punonjes manovrator te mjeteve te renda te cilat 4 (kater) atomakinist dhe 2(dy) eskavatorist .

Per kto punonjes duhet te paraqes kontratatat e punes te vlefshme, deshmit e drejtimit te vlefshme te leshuara nga institucionet perkatese si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise per 3 muajt e fundit.

11. Operatori ekonomik ofertues duhet te ket te punesuar specialiste me Kontrate Pune , Certificate Trajnimi edhe Deshmi kualifikimi e Sigurimi si me poshte :

1. Specialist Hidraulik 2 (dy)
2. Specialist Hekurkthyes 1 (nje)
3. Specialist Saldator 1 (nje)
4. Specialist Elektracist 1 (nje)

Te figurojne ne listpagesat e shoqerise per 3 muajt e fundit.

7. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, apo te kontraktuar nga jashte 1 (një) mjek të përgjithshëm referuar VKM nr.692, dt.13.12.2001, “Për masat e vecanta te sigurimit dhe mbrojtjes se shëndetit në punë” i ndryshuar me VKM Nr. 742, dt.06.11.2003“Për masat e vecanta te sigurimit dhe te mbrojtjes se shëndetit në punë”, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, urdhër mjeku, diplome.

Te figuroje ne listpagesat per 3 muajt e fundit.

8. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisore kodi III.2.B (Grumbullim dhe transportim te mbetjeve jo te rrezikshme) në selinë e ushtrimit të aktivitetit.

9. Kontrate Funizimi Impjantin e asfaltit dhe Impjantin e Seleksionimit te inerteve

Per Impjantin e asfaltit dhe Impjantin e Seleksionimit te inerteve duhet te paraqitet dokumenti qe verteton pronesine, Leje Mjedisore me kod III.1.B (lëshuar nga QKB) Nese nuk eshte ne pronesi duhet te paraqitet kontrata e qira/furnizimit (e lidhur para noterit) me poseduesin e impiantit perkates, shoqeruar me dokumentin e pronesise, Leje Mjedisore me kod III.1.B (lëshuar nga QKB)

10.Pajisjet e domosdoshme për kryerjen e këtij investimi duke u nisur nga lloji dhe sasia e volumeve të punimeve dhe afati i punimeve si dhe kushtet në të cilat do të kryhet ky investim jane si vijon;

Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtes mbi 15-20 ton	copë 4 (Kater)	Ne pronesi ose me qera
---	-----------------	------------------------

Dokumenta Standarde të Tenderit

Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtes 8-10 ton	copë 2 (Dy)	Ne pronesi ose me qera
Kamion kapacitet mbajtes 3.5-7.5 ton	copë 2 (Dy)	Ne pronesi ose me qera
Kamion kapacitet mbajtes 2.5-3 ton	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine	copë 3 (Tre)	Ne pronesi ose me qera
Asfaltoshtruese	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Autobot Uji	copë 2 (Dy)	Ne pronesi ose me qera
AutoBetoniere	copë 2 (Dy)	Ne pronesi ose me qera
Rrul	copë 2 (Dy)	Ne pronesi ose me qera
Pres Betoni	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me Goma	copë 2 (Dy)	Ne pronesi ose me qera
Skrep /Fadrom	copë 3 (Tre)	Ne pronesi ose me qera
Minieskavator	copë 2 (Dy)	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me zinxhir	copë 1 (Nje)	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me krah te gjate	copë 1 (Nje)	Ne pronesi ose me qera
Cekic pneumatik	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Bobcat	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Vibrator betoni	copë 2 (dy)	Ne pronesi ose me qera
Depozite per grumbullim materiale	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Auto Vinc	cope 1 (Nje)	Ne pronesi ose me qera
Makineri Betoni	cope 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Matrapik	copë 4 (Kater)	Ne pronesi ose me qera
Deflektometer Shtresash	cope 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
GPS	cope 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Instrument Nivelimi	cope 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Gjenerator	Cope 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Pirun	cope 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Tokmak Ngjeshes Dheu	copë 4 (Kater)	Ne pronesi ose me qera
Saldatrice	cope 2 (dy)	Ne pronesi ose me qera
Helikopter nivelimi	cope 1 (Nje)	Ne pronesi ose me qera
Rrjet plastike per mbrojte ne pune	1000m2	Ne pronesi ose me qera

11. Pajisje të tjera ndihmëse, (të cilat duhet të vërtetohen me deklaratë sipas shtojcës 9, të DST:

Nr	Mjete mbrojtese	njesia	sasia	statusi
1	Kokore	copë	30	Në pronesi ose me qera
2	Tabela Sigurimi Teknik	copë	45	Në pronesi ose me qera
3	Kuti Ndihme e shpejt	copë	15	Në pronesi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

4	Prozhektor për ndricim	copë	10	Në pronesi ose me qera
5	Çizme	copë	10	Në pronesi ose me qera
6	Doreza	copë	30	Në pronesi ose me qera
7	Kominoshe	copë	30	Në pronesi ose me qera
8	Lopat	copë	10	Në pronesi ose me qera

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, , leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme) , të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).**

12.Cdo ofertues duhet te paraqese grafikun e punimeve te firmosur dhe vulosur nga administratori. Ne rast BO grafikun e punimeve duhet te jete i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve perkates.

13. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet te paraqesë Certifikatë të cilesisë së punimeve

Certifikate ISO 9001-2008 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise

Certifikate ISO 14001:2004 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit

Certificate ISO 45001-2018 - Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune

Çertifikaten ISO 27001:2013 - Menaxhimin e sigurimit te informacionit

Certifikate ISO 39001:2012 – Standard per Sigurine ne Trafikun Rrugor

Certifikate ISO 28001:2007 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Sigurise per zinxhirin e funizimit

Certifikate ISO 15128:2005 Riparim e Sistemimeve te Kanalaizimit dhe Kullimit

Certifikate ISO 333/2011 Menaxhimi i Hekurit

Certifikate ISO 1452 -1:2009 – Standard per Sistemet e tubacioneve plastike per funizimin me uje , kullimet dhe kanalizimet nentoksore dhe mbitoksore nen presion.

AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Dokumenta Standarde të Tenderit

Të gjithë dokumentat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të perkthyer , origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Ne respektim të nenit 23 të LPP-se në të gjitha rastet kur përmendet “marke” përfshihet termi “ekuivalent”.

Në çdo rast, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kërkojë kopjen origjinale të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik ofertues. Rastet e mos-dorëzimit të dokumentacionit origjinal brenda afatit të kërkuar nga AK, konsiderohen si kusht për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

PËRGATITI: "MAGNA CHARTA" SH.P.K

e-mail: magnacharta2019@gmail.com

**HARTIMI I PROJEKTIT PER "NDERTIMI I RRJETIT TERCIAL TE KANALIZIMEVE
K.U.Z KSAMIL**

SPECIFIKIME TEKNIKE 1

"NDERTIMI I RRJETIT TERCIAL TE KANALIZIMEVE, KSAMIL"

HARTIMI I PROJEKTIT PER "NDERTIMI I RRJETIT TERCIAL TE KANALIZIMEVE K.U.Z KSAMIL

1. TE PERGJITHSHME

Paragrafet ne kete kapitull jane plotesues te detajeve te dhena ne detyren e projektimit.

2. PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM I OBJEKTIT

Qellimi I ketij projekti eshte investigimi ne terren i situates problematike te krijuar, dhe dhena e zgjidhjeve tekniko-ekonomike te nevojshme per zgjidhjen e problematikes se mbrojtjes se tokave bujqesore dhe qendrave te banimit nga permbytjet e lumit Vjosa.

Hartimi i projektit synon qe te mbroje tokat dhe jeten e banoreve te cilet banojne ne keto zona.

3. ZEVENDESIMET

Zevendesimi i materialeve te specifikuara do te behen vetem me aprovimin e Mbikeqyresit te Punimeve ne se materiali i propozuar per tu zevendesuar eshte i njejte ose me i mire se materialet e specifikuara; ose nese materialet e specifikuara nuk mund te sillen ne sheshin e ndertimit ne kohe per te perfunduar punimet e Kontrates per shkak te kushteve jashte kontrollit te Sipermarresit. Qe kjo te merret ne konsiderate, kerkesa per zevendesim do te shoqerohet me nje dokument deshmi te cilesise, ne formen e kuptimit te certifikuar materialit te specifikuar ashtu edhe te atij qe propozohet te ndryshohet.

4. DOKUMENTAT DHE VIZATIMET

Sipermarresi do te verifikojte te gjitha dimensionet, sasite dhe detajet te treguara ne Vizatimet, Grafiket, ose te dhena te tjera. Mos zbulimi ose korigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do ta lehtesoje Sipermarresin nga pergjegjesia per pune te pakenaqeshme. Sipermarresi do te rnarre persiper te gjithë pergjegjesine ne berjen e llogarive te madhesive, Ilojeve dhe sasive te materialeve dhe pajisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas Kontrates. Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje, ndersa nje udhezim i plote do te jepet nga Punedhnesi ne se gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen.

5. KOSTOT E SIPERMARRESIT PER PUNIME TE PERKOHSHME

Do te kihet parasysh qe Sipermarresit nuk do te behet asnje pagese shtese mbi cmimet njesi te kuotuar per kostot e zerave te ndryshem para e gjate ndertimit te objektit d.m.th. per sigurimin e transportit, drite, energjine, veglat dhe pajisjet,ose per furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impjanteve te ndertimit, rugeve te hyrjes, te komoditeteve sanitare heqje e mbeturinave, pun en, furnizimin me uje, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punes, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura te tjera te perkoheshme, paj isje dhe materjale, ose per kujdesin mjeksor dhe mbrojtjen e shendetit, ose per patrullat dhe rojet, ose per ndonje sherbim tjetër, lehtesi, gjera, ose materjale te nevojshme ose qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne Kontrate.

6. PIKETIMI I PUNIMEVE

Sipermarresi, me shpenzimet e tij duhet te beje ndertimin e modinave dhe te piketave sic kerkohet, ne perputhje me informacion in baze te Punedhnesit, dhe do te jete pergjegjesi i 2

"NDERTIMI I RRJETIT TERCIAL TE KANALIZIMEVE, KSAMIL"

vetem per perpikmerine. Sipermarresi do te jete pergjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacion in baze qe i eshte dhene dhe ne asnje menyre nuk do te lehtesohet nga pergjegjesia e tij ne se nje informacion i tille eshte i manget, jo autentik ose jo korrekt. Ai nderkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhenesi dhe ne asnje rast nuk i jepet e drejta te beje ndryshime ne vizatimet e kontrates, per asnje lloj kompensimi per korigjimet e gabimeve ose te mangesive. Sipermarresi do te ruaje te gj itha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, te bera ose te vendosura gjate punes, te mbuloje koston e rivendosjes se tyre nese ato demtohen dhe te mbuloje te gjitha shpenzimet per ndreqjen e punes se bere jo mire per shkak te mosmirembajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim te ketyre pikave te vendosura, modinave dhe piketave. Cdo pune e bere jashte akseve, kuotave dhe kufinjve te treguara ose te mosmiratuara nga Punedhenesi nuk do te paguhet, dhe Sipermarresi do te mbuloje me shpenzimet e tij germimet shtese gjithrnone nen drejtimin e Mbikqyresit te Punimeve.

7. FOTOGRAFIMI I PUNIMEVE

Sipermarresi duhet te beje fotografi me ngjyra sipas udhezimeve te Mbikqyresit te Punimeve ne vendet e punes per te demonstruar kushtet e sheshit perpara fillimit, progresin gjate punes se ndertimit dhe mbas perfundimit te punimeve. Nuk do te behen pagesa per fotografimin e kantierit te punimeve pasi keto shpenzime jane parashikuar te mbulohen nen koston administrative te Sipermarresit.

8. BASHKEPUNIMI NE ZONE

Ndertimi do te behet ne zona te kufizuara. Sipermarresi duhet te kete vecanerisht kujdeset ne:

- a) Nevojiten per te mirembajtur sherbimet ekzistuese dhe mundesite e kalimit per banoret dhe tregetaret qe jane ne zone, gjate periudhes se ndertimit.
- b) Prezencen e mundshme te kontraktoreve te tjere ne zone me te cilet do te koordinohet puna.

E gjithë puna, do te behet ne nje menyre te tille, qe te lejoje hyrjen dhe perballimin e te gjithë pajisjeve te mundshme per ndonje Kontraktor tjetër dhe punetoreve te tij, stafin e Punedhenesit si edhe te cdo te punonjesit qe mund te punesohet ne zbatim dhe ose punimet ne zone ose prane saj per cdo objekt qe ka lidhje me Kontraten ose cdo gje tjetër.

Ne pregatitjen e program it te tij te punes, Sipermarresi gjate gjithë kohes do te beje llogari te plote dhe te kooperoje me programin e punes se Kontraktoreve te tjere, ne menyre qe te shkaktoje nje minimum interference me ta dhe me publikun.

9. MBROJTJA E PUNES DHE E PUBLIKUT

Sipermarresi do te marre masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesuar dhe te jetes publike. Masat e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikueshme, kodeve te ndertimit do te respektohen. Gjate zbatimit te punimeve Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet te vendosi dhe te mirembaje gjate nates pengesa te tilla dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidentet.

10. MBROJTJA E AMBIENTIT

Sipermarresi me shpenzimet e vete, duhet te ndermarre te gjitha veprimet e mundshme per te siguruar mbrojtjen e ambientit lokal te sheshit te ndertimit. 3

"NDERTIMI I RRJETIT TERCIAL TE KANALIZIMEVE, KSAMIL"

11. GERMIMI

Germimi duhet të kryhet në përputhje me nivelet dhe vijën e prerjeve siç tregohet në Vizatime. Cdo thellesi me e rradhe e germuar në nivelin e formacionit, brenda tolerancës së lejuar, duhet të bëhet mirë me mbushje me materiale të pranueshme me karakteristika të ngjashme nga Sipermarresi me shpenzimet e tij.

Kujdes i vecantë duhet të ushtrohet kur germohen prerje për të mos hequr material përtej vijës së specifikuar të prerjes dhe me pas duke shkaktuar rrezikshmeri për qëndrueshmëri të strukturave të përrësive ose duke shkaktuar erozion ose disintegrimit të pjeseve të ngjeshura.

PerMasat e prerjeve duhet të jenë në përputhje me detajet e seksioneve tërthore siç tregohen në Vizatime.

Germimi për skarifikimin e tabanit të argjinaturës do të kryhet për të krijuar kushte të përshtatshme për lidhjen e mbushjes së re të trupit të argjinaturës, skarifikimi do të bëjë të gjithë bimesinë ekzistuese dhe rrenjet e tyre, si dhe shtresën vegjetale dhe dherat me struktura të dobëta dhe të demtuar nga vegjetacioni, duke aritur në dhera kompakte dhe me struktura të pa prishur, të gjitha dherat që do dalin nga skarifikimi do të largohen dhe nuk do përdoren për rimbushjen e trupit të ri të argjinaturës.

12. HEQJA E MATERIALEVE TË TËPERTA NGA GERMIMI

I gjithë materiali i tëpërt i germuar nga Sipermarresi do të largohet në vendet e aprovuara.

13. MBUSHJA DHE NGJESHJA

Punimet mbushëse do të realizohen në përputhje me permasat dhe nivelet që tregohen në vizatime dhe/ose siç përcaktohen ndryshe me shkrim nga Mbikqyri i Punimeve. Punimet do të realizohen në nivelin që të kënaqin kërkesat e Mbikqyrit të Punimeve.

Sipermarresi do të jetë përgjegjës për qëndrueshmëri të mbushjeve dhe rrafshimit të skarpave sipas kushteve të Kontrates.

Mbushja e trupit të ri të argjinaturës do të realizohet me dhera me përmbajtje argjile dhe nga ana e lumit do të vishet me qilim zhavori sipas prerjes tip. Ndalohet përdorimi për mbushje të dherave më të mëdha dhe atyre ranore. Karrierat për marrjen e dherave do përcaktohen nga Pushteti Lokal, por do të miratohen nga gjeologu i firmës kontraktore për të plotësuar kushtet e kërkuara në projekt. Përpara marrjes së dherave do të bëhet skarifikimi dhe pastrimi i karrierës nga bimesia dhe materialet organike, marrja e të pakten katër kampioneve dhe bërja e analizave të plota në një laborator të specializuar për të përcaktuar karakteristikat e plota fiziko-mekanike të dherave të karrierës, si dhe lageshtinë optimale dhe mënyrën e ngjeshjes për të arritur një peshe volumore skeletit prej >1.8-2.1 ton/m³. Dherat nga karriera në trupin e argjinaturës do transportohen me automjet dhe do rrafshohen me buldozier me shtresë jo më të mëdha se 35-50cm. Do të lagën me ujë për krijimin e lageshtisë optimale për qëllime të nevojshme dhe do ngjeshen me rrul vibrues me dhembëza me peshe 15-20 ton me 5-6 kalime deri sa të arrihet pesha volumore e skeletit prej 2.0-2.1 ton/m³. Kontrolli i ngjeshjes së materialit do realizohet nëpërmjet marrjes së kampioneve dhe bërjes së analizave në laboratorin fushor që firma do të ngrejë pranë objektit, për përcaktimin e lageshtisë dhe peshës volumore të skeletit për cdo shtresë, si dhe marrja e të pakten tre kampioneve dhe bërjen e analizave të plota fiziko-mekanike për cdo 2500 m³ dhe të hedhur në vepe në një laborator të specializuar e të licensuar. 4

"NDERTIMI I RRJETIT TERCIAL TË KANALIZIMEVE, KSAMIL"

14. BETONI

Te gjitha betonet e markave mbi 150 do te realizohen me inerte te Iarte e te fraksionuar me tre fraksione dhe cemento te markes M.400, ndersa betonet e markes M.IOO do realizohen me zhavor lumi me granulometri e pasterti te pershtateshem.

Te gjitha betonet do te pregatiten detyrimisht me makineri. Perpara prodhimit te betonit, ne nje laborator te spezializuar do te percaktohet reptura e betonit per edo marke ne perputhje me materialet inerte qe do te perdoren. Per kete nga ana e laboratorit do te leshohet zyrtarisht certifikata e reptures per secilen marke.

PUNIMET E BETONIT

- Materialet përbërëse

Betoni do të përbëhet nga çimento, agregate të graduara dhe uji, plotësisht të përziera, të vendosur dhe të ngeshur sipas specifikimeve në paragrafët e mëposhtëm.

- Çimento

Çimento Portland (CEI), çimento e përbërë portland (CEII), çimento e furnaltave (CEIII) dhe çimento me skorje (CEIV) siç është specifikuar ne **BS EN 197**

Çimento Portland që i reziston sulfateve duhet të jetë në përputhje me **BS EN 197-1:2011** dhe referencat e tij.

Çimento që do të përdoret për prodhimin e betonit do të mbartin vulën origjinale të “Conformité Européene”.

- Agregatet e betonit

Të gjitha agregatet e betonit duhet të merren nga burime të aprovuara nga Mbikëqyrësi. Duhet të merren mostra të agregateve të trashë dhe të imët dhe testet specifike do të realizohen para se të behet porosia në lidhje me cilësinë ose llojin, ose siç udhëzohet nga Mbikëqyrësi për të konfirmuar përshtatshmërinë e tyre për betonin. Agregatet nuk duhet të përmbajnë elementë të dëmshëm pasi mund të dëmtojnë qëndrueshmërinë e betonit ose të shkaktojnë korrozionin e armaturës.

- Përmasat e grimcave të agregateve

Përmasa maksimale nominale e agregateve nuk duhet të kalojë 30 mm, duke siguruar që përmasa maksimale e agregateve të jetë si më poshtë:

- një çerek i dimensionit më të vogël të një elementit struktural;
- 5 mm më pak se distanca ndërmjet shufravete armaturës, përveç rasteve kur janë marrë masa të veçanta, si p.sh. grupimi i shufrave të armimit;
- Sa 1.3 herë trashësia e betonit.

Agregatet duhet ti pershtaten kerkesave te BS EN12620:2002+A1:2008 - “Agregatet për betonin”

5

“NDERTIMI I RRJETIT TERCIAL TE KANALIZIMEVE, KSAMIL”

- Agregatet e trashë

Agregati i trashë i përdorur në beton ose për ndonjë qëllim tjetër duhet të jetë ose zhavorr ose gur i copëzuar në përmasat e dëshiruara.

Gradimi i agregateve të trasha me analizë do të jetë brenda limiteve të dhëna në **BS EN**

12620:2002+A1:2008. Nëse një analizë e përmasave të grimcave të materialit tregon mungesë në një përmasë të veçantë të tillë që të ndikojë densitetin e betonit, Mbikëqyrësi do t'i kërkojë kontraktorit të shtojë një sasi të tillë agregati të një përmasë të veçantë që ai mund ta konsiderojë të këshillueshme. Në çdo rast materiali kur përzihet me agregate të holla do të prodhojë një përzierje të graduar mirë nga përmasa më e madhe te ajo më e vogla e specifikuar për të siguruar një beton me densitet të lartë.

- Agregati i imët

Agregati i imët që përdoret për betonin duhet të jetë rërë e pastra dhe duhet të jetë larë tërësisht para përdorimit.

Rëra për përdorim në llaçin e çimentos dhe finon duhet të jetë në përputhje me **BS EN**

13139:2002 "Agregatet për llaçin"

- Uji i përzierjes

Uji për përzierjen e betonit duhet të jetë në përputhje me **BS EN 1008:2002**.

- Struktura e betonit

Betoni do të përgatitet i tillë që pas tkurrjes të ketë një strukturë të mbyllur, p.sh. kur të ngjishet në një menyrë standarde, vëllimi i përmbajtjes së ajrit nuk do të jetë më shumë se 3% për përmasën nominale të agregatit $\geq 16\text{mm}$ dhe 4% për përmasën nominale të agregatit $< 16\text{mm}$, pa përfshirë ajrin dhe porët e agregatit.

- Përmbajtja e klorureve në beton

Sasia e joneve të klorit të betonit nuk duhet ta kalojë vlerën e vendosur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4-1 **Cl – si përqindje e**
Përmbajtja e klorit **masës së çimentos**
në beton **Betoni**

Beton	1%
Beton i armuar	0,4%
Beton i paranderur	0,2%

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç

Dokumenta Standarde të Tenderit

rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomike më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Dokumenta Standarde të Tenderit

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS **Punët – Procedura e Hapur**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha

Dokumenta Standarde të Tenderit

bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor qe është pjese e kesaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar ne ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore

ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
